



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS  
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



**KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK)**, në bazë të nenit 108 paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 7 paragrafi 1 pika 1.12, 1.14, nenit 28 të Ligjit Nr. 06/L- 055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, Rregullores (15/2016) për Transferimin dhe Caktimin e Gjyqtarëve, në mbledhjen e 218-të, të mbajtur me datë 27 maj 2019, mori këtë:

## V E N D I M

- I. Refuzohet kërkesa e z. Gezim Ademi, gjyqtar në Gjykatën Themelore në Mitrovicë, për transferim nga Gjykata Themelore në Mitrovicë, në Gjykatën Themelore në Prishtinë.
- II. Vendimi hyn në fuqi me datë 27 maj 2019.

## A r s y e t i m

Këshilli Gjyqësor i Kosovës me datë 12 prill 2019, ka pranuar një shkresë nga gjyqtari Gezim Ademi, përmes së cilës kërkon që t'i mundësohet transferimi nga Gjykata Themelore në Mitrovicë, në Gjykatën Themelore në Prishtinë.

Arsyen e kërkesës së tij z. Ademi, e mbështet në vështirësitë që i paraqiten në procesin e punës, për shkak të udhëtimit të përditshëm në Mitrovicë, meqë i njëjti vendbanimin e përhershëm e ka në Fushë Kosovë.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, në takimin e mbajtur me datë 27 maj 2019, shqyrtoi kërkesën e gjyqtarit Gezim Ademi, të cilën e refuzoi, pasi që i njëjti nuk mund të aplikoj pranë KGJK-së për transferim të përhershëm nga Gjykata Themelore në Mitrovicë, në Gjykatën Themelore në Prishtinë, sepse në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me shpallje të konkursit të brendshme për transferim të përhershëm, po ashtu ky transferim nuk mund të bëhet për shkak se gjyqtari është me

mandat fillestar, bazuar në nenin 8 paragrafi 1 pika 1.1 të Rregullores (15/2016) për Transferimin dhe Caktimin e Gjyqtarëve, ndër kriteret e parapara për transferim të përhershëm të gjyqtarëve parashihet se gjyqtari duhet të jetë me mandat të përhershëm, ndërkaq z. Gezim Ademi, është gjyqtar me mandat fillestar i emëruar nga Presidenti i Republikës së Kosovës, me datë 31 korrik të vitit 2017. Ndërsa sa i përket mundësisë së transferimit të përkohshëm, KGJK konsideron se nuk ka rrethana të adresuara (jashtëzakonshme) për realizimin e domosdoshëm të këtij lloj transferi.

Andaj, nga se u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

  
Skender COÇAJ,  
Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës

*Kopje e vendimit i dërgohet:*

- Z. Gezim Ademi, gjyqtar në Gjykatën Themelore në Mitrovicë;
- Kryetarit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë;
- Kryetarës së Gjykatës Themelore në Prishtinë;
- Arkivit.